

FEDERATA E PINGPONGUT E KOSOVËS

RREGULLORE

**PËR REPRESENTACIONET E
PINGPONGUT TË KOSOVËS**

RREGULLORE PËR REPREZENTACIONET E PINGPONGUT TË KOSOVËS

I. Dispozita të përgjithshme

Neni 1.

Reprezentacionet e pingpongut të Kosovës sipas përmbajtjes së punës dhe organizimit funksionojnë si rezultat i të arriturave më të mëdha në sportin e pingpongut në Kosovë. Këto janë të themeluara në bazë të grupmoshës, kategorisë dhe gjinisë:

Femrat: - kadetet deri në moshën 14 vjeç
 - junioret prej 14 – 17 vjeç
 - senioret

Mashkujt: - kadetët deri në moshën 14 vjeç
 - juniorët prej 14 – 17 vjeç
 - seniorët

Statusi i reprezentuesit të Kosovës në kategorinë e caktuar fitohet me arritjen e rezultateve kulminante në pingpong dhe me gadishmëri për përfaqësimin e interesave sportiv të Kosovës.

Drejtori, trajnerët dhe personeli mjekësor i reprezentacionit gjithashtu konsiderohen si anëtarë të reprezentacionit.

Neni 2.

Kuvendi i FPPK çdo vjet, në kuadër të kalendarit të garave të FPPK deri më 1. shtator miraton edhe kalendarin e aktiviteteve dhe paraqitjeve të reprezentacionit të Kosovës. Ky kalendar u dorëzohet të gjithë kandidatëve reprezentativ të cilët marrin obligimin e pranimit me shkrim të programit të definuar. Për kandidatë të caktuar të reprezentacionit (reprezentues të cilët garojnë në vende të huaja, etj) mund të definojnë edhe programe individuale.

Neni 3.

Klubi nga rradhët e të cilët është zgjedhur kandidati-reprezentuesi është i obliguar që programin e tij të punës ta harmonizojë me nevojat e reprezentacionit, kandidati të zgjedhur t'i mundësojë kushte optimale për përparim profesional dhe t'i lejojë pjesëmarrje në të gjitha fazat e aksioneve të reprezentacionit.

Neni 4.

Në të gjitha pregaditjet, paraqitjet dhe aksionet tjera reprezentuesit-et kanë obligim që të kryejnë të gjitha obligimet e caktuara nga udhëheqësia profesionale e reprezentacionit, si dhe tu përmbahen vendimeve të personit përgjegjës për përfaqësim të cilin e cakton Kuvendi i FPPK.

Neni 5.

Kuvendi i FPPK dhe organet e tij janë të obliguar të sigurojnë kushte optimale dhe mundësi materiale për punë të seleksioneve të reprezentacioneve të Kosovës.

Neni 6.

Për punë dhe krijimtari të suksesshme anëtarëve të reprezentacioneve mund t'u jepen mirënjohje.

II. REPREZENTUESIT-ET

Neni 7.

Statusin e reprezentuesit të Kosovës në kategorinë e caktuar e fiton lojtari:

- shtetas i Kosovës i regjistruar në FPPK apo me pajtimin e FPPK jashtë shtetit,

- me arritjen e kualitetit kulminant në sportin e pingpongut,
- i gatshëm që në mënyrën më të mirë të përfaqësojë këtë Federatë dhe interesat sportiv të Kosovës,
- i cili i pranon vendimet e kësaj Rregulloreje, Statutit dhe akteve të përgjithshme të FPPK.

Neni 8.

Në kryerjen e programit të reprezentacionit lojtari është i obliguar:

- para fillimit të sezonit në afat prej 8 ditësh pas pranimit të programit të reprezentacionit për vitin e ardhshëm, me shkrim të vërtetojë pranimin e programit, nga se në të kundërtën e humbë statusin e kandidatit për reprezentacion,
- që në çdo takim reprezentativ të ketë reketin rezervë,
- të përgjegjet në çdo thirrje të drejtorit të reprezentacionit,
- në pregaditje, paraqitje dhe aksione tjera të reprezentacionit të pranojë vendimet e drejtorit, trajnerit apo personit të cilin e ka emëruar Kuvendi për përfaqësues të FPPK,
- me vullnet të kryejë të gjitha detyrat të cilat në pregaditje i parashtron trajneri,
- maksimalisht të angazhohet duke shfrytëzuar diturinë e tij, shkathtësitë dhe aftësitë psikofizike me qëllim të arritjes së rezultatit sa më të mirë sportiv,
- pranojë vendimet e FPPK se me cilën pajisje dhe me cilat porosi propaganduese do të paraqitet reprezentuesi i Kosovës në takimet ndërkombëtare,
- me të gjitha aktivitetet dhe sjelljet e tij të jep kontribut në renomenë e Federatës së tij dhe sportit kosovar në përgjithësi.

Neni 9.

Pjesëmarrjen në programin e reprezentacionit mundet ta tërhejë vetëm me arsye të dëshmuara dhe të arsyeshme.

Dorëhjekja me arsyetim i dërgohet drejtorit të reprezentacionit.

Për arsyeshmërinë e dorëhjekjes vendosë drejtori i reprezentacionit.

Dorëhjekja e paarsyeshme tërheq përgjegjësinë disiplinore apo largim nga reprezentacioni në kohë të caktuar.

Neni 10.

Për mospërbushje të obligimeve nga Neni 8. i kësaj rregulloreje, drejtori i reprezentacionit apo personi i caktuar nga ana e Kuvendit të FPPK për përfaqësim mund të merrë masa disiplinore si në vijim:

- largim nga një pjesë e pregaditjeve,
- largim nga pregaditjet në tërësi,
- largim nga pjesëmarrja në seleksion të reprezentacionit një ndeshje,
- largim nga pjesëmarrja në seleksion të reprezentacionit një garë.

Kur drejtori i reprezentacionit apo personi i caktuar për përfaqësimin e FPPK aplikon masat disiplinore ndaj një lojtari, ai duhet për këtë masë të lajmërojë Kuvendin.

Neni 11.

Që të mund të zgjedhet për pjesëmarrje në Garat Olimpikë, lojtari duhet:

- me propozim të Federatës së tij të propozohet nga Komiteti Olimpik i Kosovës,
- të pranojë rregullat e jodhunës dhe fair-play-it,
- të mos përdorë cilëndo lloj të substancave të ndaluara nga ITTF dhe Komitetit Olimpik Ndërkombëtar (KON),
- Të jetë i gatshëm t'i nënshtrohet të gjitha testeve mjekësore, sipas rregullave të Komisionit Mjekësor të KON,
- Pranojë që në veshjen apo pajisjen e tij nuk do të ketë asnjë porosi përveç atyre shenjave të aprovuara nga KON,
- Të pranojë që për pjesëmarrje në Lojëra Olimpikë të mos kërkojë shpërblim,
- Sjelljet e tij dhe vendimet t'i harmonizojë me rregullat e ITTF dhe KON.

Kandidati për pjesmarrje në Lojëra Olimpike i akuzuar për thyerjen e rregullave të lartëpërmendura ka të drejtë të kërkojë diskutim në Komitetin Olimpik të Kosovës, vendimi i të cilit është përfundimtar.

III. DREJTORËT E REPREZENTACIONEVE

Neni 12.

Udhëheqja e reprezentacionit të Kosovës është në përgjegjësi të drejtorit të reprezentacionit (në tekstin e mëtutjeshëm: drejtori).

Neni 13.

Drejtorët emërohen me vendim të Kuvendit të FPPK, në veçanti për reprezentacionin e mashkujve dhe atë të femrave.

Neni 14.

Drejtori zgjedhet me anë të shpalljes publike në kohëzgjatje prej 4 vitesh, ndërsa personi i njejtë mund të ri-zgjedhet.

Neni 15.

Që një person të mund të zgjedhet drejtor ai/ajo duhet të përmbushë këto kritere:

- të ketë kualifikim të lartë shkollor,
- të ketë tri vjet përvojë pune,
- të njohë gjuhën angleze,
- të posedojë rezultate të dëshmuara në punë profesionale.

Neni 16.

Marrëdhënia e punës themelohet në bazë të marrëdhënies kontraktuese në katër vjet, ndërsa personi i njejtë mund të rizgjedhet.
Nëse nuk ekzistojnë kushtet për themelimin e marrëdhënies së punës atëherë mund të themelohet puna honorare në afat të caktuar.

Neni 17.

Drejtori është i pavarur në punën e tij.

Neni 18.

Drejtori mund të shkarkohet edhe para skadimit të afatit kontraktues në këto raste:

- me kërkesën e tij personale,
- nëse si pasojë e realizimit jokualitativ të programit të punës dhe pregaditjeve të reprezentacionit mungojnë rezultatet e duhura,
- nëse me aktivitetet e tij dëmton rrespektin e sportit të pingpongut, e posaqërisht të Kosovës,
- në të gjitha rastet tjera të parapara me Ligj.

Neni 19.

Nëse drejtori paraqet dorëheqje apo obligimet i përfundojnë për ndonjë arsye tjetër, Kuvendi i FPPK do të emërojë kryesin e detyrës deri në emërimin e drejtorit të ri.

IV. DETYRAT DHE PUNËT E DREJTORIT TË REPREZENTACIONIT

Neni 20.

Drejtori i reprezentacionit përpilon:

- Propozimin e programit njëvjeçar dhe katërvjeçar të punës së reprezentacionit,
- Propozimin e planit të pregaditjeve të reprezentacionit,

- Propozimin e kalendarit të garave të reprezentacionit për sezonin e ardhshëm, duke marrë parasysh që garat lokale të jenë në funksion të paraqitjes sa më të suksesshme të reprezentacionit në gara ndërkombëtare,
- Propozimin e obligimeve të kandidatëve për reprezentacion për vitin e ardhshëm.

Neni 21.

Drejtori vërteton propozimet për:

- listën e gjerë dhe të ngushtë të kandidatëve për reprezentacion,
- vendin, kohën dhe terminin e mbajtjes së pregaditjeve,
- reprezentuesit për lavdata dhe shpërblime në bazë të rezultateve të arritura,
- trenerët e reprezentacionit (mashkujve dhe femrave) si dhe trenerët e seleksioneve.

Neni 22.

Drejtori udhëheq dhe koordinon:

- punën e të gjithë trenerëve të reprezentacioneve dhe vërteton raportin me shkrim për punën e tyre (mujore dhe vjetore).
- Pregaditjet për paraqitjet e reprezentacionit,
- Seleksionin gjegjës në paraqitje në vend dhe jashtë vendit, me çrast në bashkëpunim me trenerin vendos për përbërjen e ekipit për gara ndërkombëtare,
- Përveç trenerit, me punën e të gjithë personave tjerë të angazhuar për nevoja të reprezentacionit (udhëheqësi teknik i pregaditjeve, sekretari teknik i reprezentacionit, etj).

Neni 23.

Drejtori përcjell përparimin dhe zhvillimin e lojtarëve të moshave të reja, kandidatëve potencial për reprezentacion, si dhe punën, rezultatet dhe formën e seleksioneve tjera.

Neni 24.

Drejtori bashkëpunon me lojtarët, trenerët e klubeve, trenerët e reprezentacioneve dhe seleksioneve si dhe me ekspertët e lëmive tjera me qëllim të krijimit të kushteve për arritjen e rezultateve kulminante sportive.

Neni 25.

Në fund të sezonit garues drejtori i dorëzon Kuvendit raport me shkrim për punën dhe rezultatet në sezonin paraprak, me vlerësimin e rezultateve të arritura, si dhe vlerësimin e punës së të gjithë trenerëve të angazhuar.

Neni 26.

Drejtori është i obliguar ti përmbahet Statutit dhe akteve tjera normative të FPPK.

Neni 27.

Drejtori patjetër duhet të marrë pjesë në punën e Kuvendit dhe organeve tjera të FPPK.

Neni 28.

Drejtori kryen edhe punë tjera nga domeni i punës profesionale të cilat nuk janë të përfshira me këtë Rregullore, të cilat i jepen nga Kuvendi i FPPK.

V. TRENERËT E REPREZENTACIONIT

Neni 29.

Trenerët e reprezentacionit të Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm: treneri) janë persona profesional të cilët drejtpërdrejtë udhëheqin me treningjet e reprezentacionit.

Neni 30.

Trenerët i emëron Kuvendi i FPPK në propozim të drejtorit të reprezentacionit.

Neni 31.

Trenerët emërohen veçmas për reprezentacionin e femrave dhe atë të mashkujve.

Neni 32.

Që një person të jetë i zgjedhur për trener të reprezentacionit duhet të plotësojë kushtet në vijim:

- të ketë shkallën e lartë apo superiore shkollore dhe rezultate të dëshmuara në udhëheqjen e reprezentacioneve, gjegjësisht lojtarëve kulminant,
- të ketë 3 vjet përvojë pune në punë të programimit dhe trenimit të lojtarëve,
- të njohë gjuhën angleze.

Neni 33.

Marrëdhënia e punës themelohet në bazë të marrëdhënies kontraktuese në katër vjet, ndërsa personi i njejtë mund të rizgjedhet.

Nëse nuk ekzistojnë kushtet për themelimin e marrëdhënies së punës atëherë mund të themelohet puna honorare në afat të caktuar.

Neni 34.

Treneri është i pavarur në punën e vet.

Për punën e tij treneri i përgjigjet drejtorit.

Neni 35.

Treneri mund të shkarkohet edhe para skadimit të afatit kontraktues në këto raste:

- me kërkesën e tij personale,
- nëse si pasojë e realizimit jokualitativ të programit të punës dhe përgatitjeve të reprezentacionit mungojnë rezultatet e duhura,
- nëse me aktivitetet e tij dëmton rrespektin e sportit të pingpongut, e posaqërisht të Kosovës,
- në të gjitha rastet tjera të parapara me Ligj.

Neni 36.

Nëse drejtori paraqet dorëheqje apo obligimet i përfundojnë për ndonjë arsye tjetër, Kuvendi i FPPK do të emërojë kryesin e detyrës deri në emërimin e drejtorit të ri.

VI. PUNËT DHE DETYRAT E TRENERIT TË REPREZENTACIONIT

Neni 37.

Treneri i reprezentacionit bashkëpunon me drejtorin e reprezentacionit në:

- Propozimin e programit njëvjeçar dhe katërvjeçar të punës së reprezentacionit,
- Propozimin e planit të përgatitjeve të reprezentacionit,
- Propozimin e kalendarit të garave të reprezentacionit për sezonin e ardhshëm, duke marrë parasysh që garat lokale të jenë në funksion të paraqitjes sa më të sukseshme të reprezentacionit në gara ndërkombëtare,
- Propozimin e obligimeve të kandidatëve për reprezentacion për vitin e ardhshëm.

Neni 38.

Treneri përpunon:

- Planin dhe programin e punës të veçantë për secilën përgatitje me detyrat specifike për secilin individ,
- Programin individual të punës së reprezentuesve-eve në bashkëpunim me trenerët e klubeve në pajtim me detyrat programore nga plani njëvjeçar, gjegjësisht katërvjeçar.

Neni 39.

Treneri i propozon drejtorit:

- listën e gjerë dhe të ngushtë të kandidatëve për reprezentacion,
- vendin, kohën dhe terminin e mbajtjes së pregaditjeve,
- reprezentuesit për lavdata dhe shpërblime në bazë të rezultateve të arritura,
- trenerët tjerë të seleksioneve të reprezentacionit.

Neni 40.

Drejtori udhëheq dhe koordinon:

- Pregaditjet dhe procesin e treningut,
- Punën e të gjithë trenerëve të seleksioneve të reprezentacionit,
- Seleksionin gjegjës në paraqitje në vend dhe jashtë vendit,
- Detyrat me trenerët e klubeve për punë individuale me reprezentues të caktuar.

Neni 41.

Treneri përcjell përparimin dhe zhvillimin e lojtarëve të moshave të reja, kandidatëve potencial për reprezentacion, si dhe punën, rezultatet dhe formën e seleksioneve tjera.

Neni 42.

Treneri bashkëpunon me lojtarët, trenerët e klubeve, organet profesionale të FPPK dhe me ekspertët e lëmive tjera me qëllim të krijimit të kushteve për arritjen e rezultateve kulminante sportive.

Neni 43.

Trenerët janë të obliguar të mbajnë ditarin e punës me të gjitha informatat e nevojshme, ndërsa në ditën e parë të muajit t'i dorëzojnë drejtorit të reprezentacionit raportin me shkrim për punën në muajin e kaluar.

Neni 44.

Trenerët janë të obliguar të paraqesin raport me shkrim nga çdo pjesëmarrje në gara dhe pregaditje dhe ate t'ia dorëzojnë drejtorit në afat prej 8 ditësh pas kthimit.

Neni 45.

Në fund të sezonit garues treneri i dorëzon drejtorit raport me shkrim për punën dhe rezultatet në sezonin paraprak, me vlerësimin e rezultateve të arritura, si dhe vlerësimin e punës së të gjithë trenerëve të angazhuar në seleksionet tjera.

Neni 46.

Treneri është i obliguar ti përmbahet Statutit dhe akteve tjera normative të FPPK.

Neni 47.

Treneri sipas nevojës merr pjesë në punën e organeve të caktuara të FPPK.

Neni 48.

Treneri kryen edhe punë tjera nga domeni i punës profesionale të cilat nuk janë të përfshira me këtë Rregullore, të cilat i jepen nga drejtori apo Kuvendi i FPPK.

VII. TRENERËT E SELEKSIONEVE

Neni 49.

Me qëllim të realizimit të planit dhe programit të seleksioneve të reprezentacionit, sipas nevojës mund të angazhohen trenerët dhe ndihmësit e tyre për punë me seleksionin e seniorëve, juniorëve dhe kadetëve.

Neni 50

Trenerët dhe ndihmësit e tyre për seleksionet e caktuara i emëron Kuvendi me propozimin e drejtorit dhe trenerit të reprezentacionit.

Neni 51.

Treneri i seleksionit apo ndihmësi i tij mund të shkarkohet nga detyra edhe para përfundimit të aksionit në këto raste:

- me kërkesën e tij personale,
- nëse si pasojë e realizimit jokualitativ të programit të punës dhe përgatitjeve të reprezentacionit mungojnë rezultatet e duhura,
- nëse me aktivitetet e tij dëmton rrespektin e sportit të pingpongut, e posaqërisht të Kosovës,
- në të gjitha rastet tjera të parapara me Ligj.

Neni 52.

Nëse treneri i seleksionit apo ndihmësi i tij paraqet dorëheqje apo obligimet i përfundojnë për ndonjë arsye tjetër, Kuvendi i FPPK me propozim të drejtorit dhe trenerit të reprezentacionit do të emërojë kryesin e detyrës deri në emërimin e trenerit të ri.

Neni 53.

Trenerët e seleksioneve dhe ndihmësit e tyre punojnë sipas planit dhe programit të unisuar dhe nën udhëheqjen e trenerit të reprezentacionit.

Neni 54.

Trenerët e seleksioneve bashkëpunojnë me trenerin e reprezentacionit në:

- Propozimin e programit njëvjeçar dhe katërvjeçar të punës së reprezentacionit,
- Propozimin e planit të përgatitjeve të reprezentacionit,
- Propozimin e kalendarit të garave të reprezentacionit,
- Propozimin e obligimeve të kandidatëve për reprezentacion,
- Planin dhe programin e përgatitjeve të caktuara me detyra të veçanta për individë.

Neni 55.

Trenerët e seleksioneve bashkarisht me trenerin e reprezentacionit hartojnë propozimin për:

- listën e gjerë dhe të ngushtë të kandidatëve për reprezentacion,
- vendin, kohën dhe terminin e mbajtjes së përgatitjeve,
- përbërjes së reprezentacionit për gara ndërkombëtare.

Neni 56.

Trenerët e seleksioneve implementojnë dhe koordinojnë:

- përgatitjet dhe të gjitha proceset e trajnimit të reprezentacionit,
- në bashkëpunim me trenerin udhëheqin reprezentacionin gjegjësisht në gara,
- detyrat me trenerët e klubeve për punë me reprezentues të caktuar.

Neni 57.

Në zbatimin e programit treneri i seleksionit bashkëpunon me lojtarët dhe trenerët e klubeve.

Neni 58.

Trenerët e seleksioneve janë të obliguar të bashkëpunojnë me trenerin e reprezentacionit në hartimin e raportit të shkruar lidhur me secilën garë dhe përgatitje të reprezentacionit.

Neni 59.

Trenerët e seleksioneve janë të obliguar të mbajnë ditarin e punës me të gjitha informatat e nevojshme, ndërsa treneri i reprezentacionit në afat prej 8 (tetë) ditësh pas përfundimit të aksionit të dorëzojnë raportin me shkrim për punën e bërë.

VIII. MBROJTJA SHËNDETËSORE

Neni 60.

Mbrojtjen shëndetësore në pregaditje dhe gara të reprezentacionit e bën mjeku i reprezentacionit të cilin e emëron Kuvendi i FPPK me propozimin e drejtorit.

Neni 61.

Mjeku i reprezentacionit përcjell gjendjen shëndetësore të individëve dhe ate të përgjithshme të reprezentacionit dhe u jep mbrojtjen shëndetësore preventive dhe kurative.

Neni 62.

Mjeku i reprezentacionit prezenton në të gjitha pregaditjet dhe garat në vend dhe jashtë vendit, përveç nëse mbrojtja shëndetësore është siguruar në tjetër mënyrë.

Neni 63.

Për nevoja të reprezentacionit mund të angazhohen edhe profile tjera të lëmisë së shëndetësisë (fizioterapeuti, etj.)

Neni 64.

Të gjithë anëtarët e reprezentacionit të angazhuar për zbatimin e programeve dhe aksioneve të reprezentacioneve të FPPK sigurohen në organizatën gjegjëse të sigurimit përmes FPPK dhe KOK (Komitetit Olimpik të Kosovës).

IX. KOMPENZIMET

Neni 65.

Udhëheqësia profesionale dhe anëtarët e seleksionit gjatë pregaditjeve dhe garave në vend dhe jashtë vendit, mund të realizojnë kompenzimin e të ardhurave personale në vendin e tyre të punës, e në pajtim me marrëveshje paraprake para angazhimit për akcione të caktuara të reprezentacionit, të gjitha këto në pajtim me kriteriumet e KOK.

Neni 66.

Anëtarët e reprezentacionit kanë të drejtë në kompenzimin e shpenzimeve të caktuara në vend dhe jashtë, në pajtim me vendimin e FPPK për aksionin e caktuar të reprezentacionit.

Neni 67.

Anëtarët e seleksioneve të caktuara mbajnë përgjegjësi disiplinore dhe financiare për pajisjen të cilën e angazhojnë, të cilën pas përfundimit të aksionit janë të obliguar ta kthejnë në rregull dhe të plotë në afat sa më të shpejtë.

Neni 68

Mënyra e dhënies së pajisjes me të cilën disponon FPPK (trenerkat, dresat, gomat, etj) për anëtarët e reprezentacionit si dhe kriteriumet e ndarjes së pajisjes do të caktohen me udhëzim të veçantë të FPPK.

Neni 69.

Mospërmbushja e obligimeve të cilat rrjedhin nga kjo Rregullore përket në jurisdiksonin e organit disiplinor dhe Rregullores disiplinore të FPPK.

Neni 70.

Kjo rregullore është miratuar në mbledhjen e Kuvendit të FPPK të mbajtur më 11.05.2002 dhe hyn në fuqi më 01.08.2002.

Kryetari i FPPK
Sherafedin Zhitia